



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR. 49, datë 31 : 07 : 2024

“PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” PËR Z. BARDHOSH GAÇE

Në kuadër të vlerësimit të figurës së Z.Brdhosh Gaçe si dhe në zbatim të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 54, pika (m) si dhe Ligjit Nr.112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit", V.K.M Nr. 861, datë 10/12/2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimorë për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit", Këshilli i Bashkisë i mbledhur në datën 31.072024, pasi mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, për dhënie tituli "Qytetar Nderi" për Z. Bardhosh Gaçe , si dhe mbështetur në relacionin e Komisionit Vendor për Dhënien e Titujve të Nderit

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien e titullit “Qytetar Nderi” për Z. Bardhosh Gaçe me motivacionin:

“Për kontribut të shquar intelektual dhe artistik në krijimtarinë letrare, eseistike, publicistikë, vepra studimore albanologjike , etnokulturore , monografi , si një zë i fuqishëm me punimete tij shkencore për përfshirjen e Polifonisë Shqiptare në listën e Trashëgimisë Kulturore Botërore të mbrojtur nga UNECSO”

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Trashëgimisë, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, neni 55 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” .

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva Yzo

KRYETARI I KËSHILLIT

Merita ISARAJ